



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 47

Datë: 16. 07. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvic, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

2. Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik:

Shqyrtimi dhe miratimi i "Logos, Sloganit dhe Dizajnit" për fushatën e Informimit Publik për zgjedhjet lokale 2021.

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: KQZ, është në përbërje me 7 anëtarë, pra kemi kuorum... E keni agjendën me vetëm një pikë... A pajtoheni me rendin e ditës...?

Miratohet rendi i ditës.

2. Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik:

Shqyrtimi dhe miratimi i “Logos, Sloganit dhe Dizajnit” për fushatën e Informimit Publik për zgjedhjet lokale 2021:

Fazli Stollaj: Këshilli, ka shqyrtuar propozimet e operatorit të llogos dhe sloganin. Ne, kemi vendosur dhe, operatori mund ta prezantojë para jush...

Mbas prezantimit, analizës dhe shqyrtimit të “logos” dhe “sloganeve” nga anëtarët e KQZ-së, Arianit Elshani, Florian Dushi, Sami Kurteshi, Fazli Stollaj, Kreshnik Radoniqi, Yll Buleshkaj së bashku me operatorin, miratuan:

1. Llogon,
2. Sloganin,
3. Dizajnin - Për fushatën e informimit publik për Zgjedhjet Lokale.

3. Të ndryshme